

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 247, dt. 18.12.2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.12.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi, rikonstruksioni dhe rinovimi i Unazës së Vogël”, Tiranë - Loti 2, Loti 3 dhe Loti 4.
 2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës heqjen e statusit *monument kulture*, të objektit banesë tip vile 1-kat, në rrugën “Urani Pano”- (II-224), kategoria e II-të.
 3. Ngarkohet Instituti i Monumenteve të Kulturës, që për objektin banesë tip vile 1-kat, në rrugën “Urani Pano” (II-224), të kryejë dokumentimin e plotë të saj grafik dhe fotografik.
 4. Materiali i plotë të depozitohet në arkivën teknike të IMK, për të shërbyer si dokumentacion studimor.
 5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI